



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**SQARIM MBI DOKUMENTAT E TENDERIT**

Referuar kërkesës për informacion të dërguar nga operatore të interesuar, si edhe bazuar në pikën 6.1 dhe pikën 17.1, të VKM-së nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, Njësia e Hartimit të Dokumentave të Tenderit, sqaron të interesuarit si më poshtë:

**Pyetja 1:**

Lidhur me Kushtet e mbulimit, referuar Ftesës për Ofertë seksioni XI, pika A, pika 1) “*Mbulimi me shërbim në shkallë popullore*”, si dhe Dokumentit të Tenderit, Shtojca 6, dhe Shtojca 20, sipas tabelës më poshtë; ky detyrim është i vlefshëm për hyrësit e rinj në treg apo edhe për operatorët ekzistues? Pasi ndryshe nga seksionet vijuese në pikat 2 dhe 3 ku specifikohet posaçërisht termi “shërbime 5G”, në lidhje me kushtin në pikën 1 për mbulimin e popullsisë nuk ka të specifikuar “shërbime 5G” por i referohet vetëm me termin “shërbime”, çka na bën të kuptojmë që ky detyrim i referohet hyrësve të rinj.

<b>% e Popullsisë</b>	<b>Afati (viti)</b>
<i>55% e popullsisë</i>	<u>2027</u>
<i>85% e popullsisë</i>	<u>2030</u>

Ju lutem të saktësohet nëse ky detyrim është për shërbimet 5G apo thjesht me shërbime mobile? (zëri/data)

**Përgjigje 1:**

Lidhur me këtë pyetje, sqarojmë se objekti i këtij tenderi është “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”. Në përputhje me objektin e tenderit, sqarojmë se mbulimi me shërbim në shkallë popullore, pra përqindjet e mbulimit të popullsisë dhe afatet respektive, janë për rrjetin që do të ndërtohet me frekuencë të brezit 3400-3800 MHz. Çdo operator, i ri apo ekzistues, që do të pajiset me autorizim individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, do të zbatojë mbulimin me shërbim në shkallë popullore, siç është përcaktuar në seksionin XI, pika A-1) “Mbulimi me shërbim në shkallë popullore” dhe Shtojcën 20, të dokumentit të tenderit.

## **Pyetja 2:**

Duke konsideruar parimin e neutralitetit teknologjik, referuar edhe në Dokumentin e Tenderit, Kreu III, Pika 1.1 “Kwadri Ligjor”, referuar kushteve për mbulim të referuar në seksionet seksioni XI, Shtojca 6, dhe Shtojca 20, në kuptimin tonë operatori mund të përdorë pjesët e brezit 3400 – 3800 MHz për të cilat do mund të rezultojë fitues nga procesi i tenderit, të kombinuara me brezat ekzistues ku operatori ka tashmë të drejta përdorimi, për të arritur kushtet e mbulimit sipas dokumentit të tenderit. A është kuptuar saktë kjo nga ana jonë, ju lutem na specifikoni?

## **Përgjigje 2:**

Në përputhje me parimin e asnjëanësisë teknologjike, operatori që do të pajiset me autorizim individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, mund të përdorë kombinim të brezave të ndryshëm të frekuencave, siç ndodh edhe sot, por operatori është i detyruar të zbatojë kushtet e mbulimit me rrjet dhe shërbime, për secilin brez frekuencash, siç janë përcaktuar në autorizimet individuale respektive. Pra, edhe për brezin 3400-3800 MHz, operatori që do të pajiset me autorizim individual, do të zbatojë përqindjet dhe afatet e mbulimit, me këto frekuenca, siç përcaktohen në dokumentin e tenderit, të cilat do të jenë edhe në autorizimet individuale që do të lëshohet për fituesit.

## **Pyetja 3:**

Në përputhje me Ftesën për Oferte, seksioni I, dhe seksionit 2 të Dokumentit të Tenderit, shoqëria kupton se ka dy limitime të përcaktuara nga AKEP në këtë dokument tenderi që janë:

- *Ofertuesi i cili është shpallur fitues në raundin e parë, skualifikohet për raundin e dytë*
- *Një ofertues NUK mund të fitojë më shumë se 3 (tre) të drejta përdorimi ose 160 MHz sasi spektri.*

Pyetja qëndron; nesë një ofertues ka depozituar brenda afatit të dorëzimit të ofertave sipas përcaktimeve në Dokumentin e Tenderit, për raundet 1, 2, 3, 4, 5 dhe gjatë procesit të hapjes së ofertave, ofertuesi vendos të tërhiqet në një nga raundet pa e hapur ofertën ekonomike respektive (psh në raundin 4), cila është procedura që duhet të ndjekë ofertuesi për tërheqjen nga oferta/ofertat e dorëzuara?

Sjellim në vëmendje se në proceset e kaluara të tenderave të zhvilluara nga AKEP për dhënien e frekuencave në përdorim, i është dhënë mundësia ofertuesve për tu tërhequr nga oferta, ndërkohë që në këtë dokument tenderi për 3400 – 3800 MHz kjo e drejtë nuk është qartësuar.

## **Përgjigje 3:**

Duke qenë se vlerësimi i ofertave do të jetë i përshkallëzuar, me 5 raunde vlerësimi, AKEP, në përfundim të vlerësimit për secilin raund, do të njoftojë ofertuesit për hapjen e raundit të radhës. Të interesuarit që duan të tërheqin ofertën e tyre nga tenderi, mund të paraqesin një kërkesë për tërheqjen, për secilin raund deri në momentin që do të hapen ofertat për raundin e radhës. Tërheqja duhet t'i komunikohet AKEP-it me shkrim para hapjes së raundit të radhës. Kërkesa e Ofertuesit

për tërheqjen e ofertës duhet të depozitohet, e futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Tërheqje Oferte”. Oferta e tërhequr do t’i kthehet ofertuesit e pahapur.